



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1397/24 Datë: 12/07/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 124-të, mbajtur me datë 25.06.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë për periudhën **pesë (5) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029):
 1. *Gjeologji BSc 180 ECTS me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik.*
- II. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 2. *Hidrologji dhe Gjeologji Inxhinierike MSc 120 ECTS me kuotën maksimumi 15 studentë për vit akademik.*
 3. *Inxhinieri Ekonomike BSc 180 ECTS me kuotën maksimumi 150 studentë për vit akademik.*
 4. *Inxhinieri Mekanike (Makineri Prodhuese) BSc 180 ECTS me kuotën maksimumi 70 studentë për vit akademik.*
- III. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë që deri më datë 15.11.2024 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për ri/akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Gjeologji BSc 180 ECTS</i>	Islam Fejza Behxhet Shala Naser Peci
2.	<i>Hidrologji dhe Gjeologji Inxhinierike MSc 120 ECTS</i>	Sabri Avdullahu Festim Kutllovci
3.	<i>Inxhinieri Ekonomike BSc 180 ECTS</i>	Florin Peci, Faruk Ahmeti Besmir Sejdiu
4.	<i>Inxhinieri Mekanike (Makineri Prodhuese) BSc 180 ECTS</i>	Fatmir Azemi Ahmet Latifi Fitim Zeqiri

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Gjeologji BSc 180 ECTS*** më 16.05.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Badea, Ana Cornelia dhe Marko Komso, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht katër (4) ndërsa Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Hidrologji dhe Gjeologji Inxhinierike MSc 120 ECTS*** më 16.05.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Badea, Ana Cornelia dhe Marko Komso, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht tre (3) ndërsa Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Inxhinieri Ekonomike BSc 180 ECTS*** më 16.05.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Piotr Grudowski dhe Marija Vasilevska, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2) ndërsa Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Inxhinieri Mekanike (Makineri Prodhuese) BSc 180 ECTS***, më 16.05.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Yilmaz Ozmen dhe Marija Vasilevska, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2) ndërsa Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 124-të, të mbajtur më datë 25.06.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi i dërgohet:

- Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.




Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë